



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 11 Prot

Tiranë, më 18/02 2013

VENDIM Nr. 9 dt. 13.02.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.02.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me diskutimin e kërkesave të qytetarëve

VENDOSI:

1. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni banese individuale 2 kate+çati e shfrytëzuar me investitor Salvator, Aurora, Amxhela Bushati, Korçë.
2. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesë dy kate me podrum, me investitor Kico Mihal Cini, Korçë.
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës në rrugën Llazo Jorganxhi, nr.17, me investitor Engjëllushe Xhipe, Korçë.
4. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni banesë individuale 1-2-3 kate me podrum, me investitor Vjollca Gërmenji, Korçë.
5. **Miratohet:** Projekt rindërtimi i dyqanit të rrënuar 2 kate+podrum me investitor Stavri Bandilli, Korçë.
6. **Miratohet me shumicë votash:** Projekt rikonstruksioni dhe shtesë kati (ambiente shërbimi) 1-3 kate + Podrum me investitor Rakibe, Mertiaz, dhe Almir Spahiu, Korçë.
7. **Nuk Miratohet:** Projekt propozim për restaurim rindërtues dhe mbrojtje integrale e banesës në shëtitoren Shën Gjergji, ish monument historik, Korçë.
8. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe shtesë 1 kat, rruga "Haki Mborja", me pronar z. Krati Busho, Korçë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE

Rruga "Aleksandër Mojsiu", nr. 76, Tiranë (AL), Email: imk@albmail.com